



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.61, datë 31.03.2022

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT ME PËLQIM DHE
VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM PA PËLQIM
NË POZICIONIN E PROKURORIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË DIBËR**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 44 pika 1 germa ç dhe 46 pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 90 të “Kodit të Procedurave Administrative”, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 5 pika 7, 11, 12 dhe 13 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të përfundojë procedurën e transferimit me pëlqim dhe vijimin e procedurave për plotësimin e një vakance të përkohshme, nëpërmjet procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më datë 31.03.2022

KRYETARI

ALFRED BALLA

